

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
“LULET E GELANES” SHPK
KREU 1

Themelimi , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia

THEMELIMI I SHOQËRISË

NENI 1

Sot ne date **19/02/2024**(dymije e njezet e kater) personat e me poshtem:

- **Znj. Ana Shurdha**, e bija e Vasillaq dhe Miranda, e datëlindjes 13/04/1990, lindur ne Sheq Marinas dhe banuese në Shkodër, Shtetase Shqiptare, madhore dhe me zotesi te plete per te vepruar, me nr. leternjoftimi 033228777, dhe nr. Personal J05413024E;
- **Znj. Gisela Ndrekë**, e bija e Sokol dhe Vjoleta, e datëlindjes 25/05/2000, lindur ne Shkoder dhe banuese në Naraç, Vau Dejes, Shtetase Shqiptare, madhore dhe me zotesi te plete per te vepruar, me nr. leternjoftimi 033414754, dhe nr. Personal K05525040E;

ne cilesine e “ortakut themelues” me vullnet të lire, te plete e te sinqerte, dhe inisiativen e tij private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë, Kodin Civil ne fuqi, ligjin nr 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqërite tregtare” dhe në ligjin nr 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit”, vendosen te themelojne shoqerine tregtare, me per gjegjesi te kufizuar, me emertimin **“LULET E GELANES” SHPK**.

FORMA E SHOQËRISË

NENI 2

Kjo Shoqeri do jetë “Shoqeri Tregtare” e formës “Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar (sh.p.k)”. Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutit të saj dhe normat e të drejtës nderkombëtare.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per një **afat te pakufizuar**, me perjashtim kur Asambleja e Ortakeve vendos ndryshe.

AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TE KUFIZUAR
“LULET E GELANES” SHPK

KREU 1

Themelimi , Forma, Emri, Kohëzgjatja, Objekti dhe Selia

THEMELIMI I SHOQËRISË

NENI 1

Sot ne date **19/02/2024**(dymije e njezet e kater) personat e me poshtem:

- **Znj. Ana Shurdha**, e bija e Vasillaq dhe Miranda, e datëlindjes 13/04/1990, lindur ne Sheq Marinas dhe banuese në Shkodër, Shtetase Shqiptare, madhore dhe me zotesi te plete per te vepruar, me nr. leternjoftimi 033228777, dhe nr. Personal J05413024E;
- **Znj. Gisela Ndreka**, e bija e Sokol dhe Vjoleta, e datëlindjes 25/05/2000, lindur ne Shkoder dhe banuese në Naraç, Vau Dejes, Shtetase Shqiptare, madhore dhe me zotesi te plete per te vepruar, me nr. leternjoftimi 033414754, dhe nr. Personal K05525040E;

ne cilesine e “ortakut themelues” me vullnet të lire, te plete e te sinqerte, dhe inisiativen e tij private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin nr 9901 datë 14.04.2008 “Për shoqërите tregtare” dhe në ligjin nr 9723 datë 03.05.2007 “Për Qendren Kombëtare të Rregjistrimit”, vendosen te themelojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin **“LULET E GELANES” SHPK**.

FORMA E SHOQËRISË


NENI 2

Kjo Shoqeri do jetë “Shoqeri Tregtare” e formës “Shoqëri me Pergjegjësi të Kufizuar (sh.p.k.)”. Shoqëria zhvillon veprimtarinë e saj tregtare në përputhje të plotë me legjislacionin shqiptar në fuqi si dhe atë civil, doganor, tatimor, fiskal dhe akte të tjera ligjore mbi bazën e aktit të themelimit dhe statutit të saj dhe normat e të drejtës nderkombëtare.

KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

NENI 3

Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje **afat te pakufizuar**, me perjashtim kur Asambleja e Ortakeve vendos ndryshe.



Two handwritten signatures are present at the bottom right of the document. The first signature is a stylized 'A' followed by 'Sh.' The second signature is a stylized 'G' followed by 'L.' A small superscript '1' is located to the right of the 'G' signature.

EMËRTIMI TREGTAR I SHOQËRISË

Kjo shoqëri do të quhet "**LULET E GELANES**" SHPK dhe vula e saj ka formën drejtkëndore në të te cilën do shkruhet "**LULET E GELANES**" SHPK

OBJEKTI I VEPRIMTARISË

NENI 4

Objekti i veprimitarise ekonomike te kësaj shoqërie është :

Tregtim lule natyrale, tregtim i aksesoreve te ndryshem per lulet natyrale, bime, peme decorative, etj. Dekore per organizim eventesh e te tjera ne lidhje me to.

SELIA E SHOQËRISË

NENI 5

Kjo shoqëri do ketë selinë e vet në adresën **Rruga Edith Durham, Nr. 20, Godine nje Kateshe Prane Adisa Shkoder, Shkoder, 4001, Shqiperi.**

KREU 2

Kapitali Themeltar, Organet e Shoqërise , Administratori ,Eksperti Kontabël dhe Prishja e Shoqërisë

KAPITALI THEMELTAR

NENI 6


Kapitali themeltar i shoqërisë me perjegjesi te kufizuar është në vlerën **200.000 Lekë (dyqind mijë leke)** dhe përfaqësohet nga kontributi i anëtarëve themelues, i ndarë në 2 kuota me vlerë nominale të një kuote prej **100.000 Lekë (njeqind mijë leke) .**

Ortaket themelues te Shoqërisë zotërojnë kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

- **Znj. Ana Shurdha, me vlere kapitali 100.000 Lekë (njeqind mijë leke), zotëron 1 kuotë koresponduese me 50% (pesedhjete) të kapitalit të shoqërisë .**
- **Znj. Gisela Ndreka, me vlere kapitali 100.000 Lekë (njeqind mijë leke), zotëron 1 kuotë koresponduese me 50% (pesedhjete) të kapitalit të shoqërisë .**

Shoqëria çel llogari bankare në monedhën vendase (lek) si dhe çdo lloj valute tjeter në banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiarë të aktivitetit të saj.

Ortakët dhe administratori të caktuar nga shoqëria depozitojnë faksimilet e firmave të tyre origjinale në bankat ku është çelur llogaria.



2

NENI 7

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave te kodit civil dhe atij tregtar.

Asambleja e ortakëve ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht ose tërësisht kontributet e saj përfshirë edhe fondet e kontributet në natyrë.

Transferimet e pjesëve të kapitalit themeltar duhet të jenë të vërtetuara me akt notarial dhe për një gjë të tillë asambleja e përgjithshme duhet te marrë paraprakisht vendim me shkrim.

NENI 8

Kapitali themeltar i shoqërisë mund te rritet ose të zvogëlohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asamblesë së Përgjithshme, vendim i cili nënshkruhet prej saj dhe dokumentohet duke bërë dhe shënimet ne regjistrin përkatës.

Me vendim të Asamblesë së Përgjithshme shoqëria ka të drejtën që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ia tjetërsojë një apo disa pësonave fizikë jashtë shoqërisë ose pësonave juridik, vendas apo të huaj mbi bazën e Aktit notarial te tjetërsuar .

Çdo vendim i Asamblesë së Përgjithshme për ndryshim të kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë QKR-së.

NENI 9

Kapitali nuk mund te jetë kurrë i përfaqesuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet para kërkesës së drejtar të QKR për njohjen dhe regjistrimin e shoqërise si person juridik.

Pjesët e kapitalit mund të transferohen të tretëve tërësisht ose pjesërisht .

ORGANET E SHOQËRISË


NENI 10

Asamblea e Përgjithshme është organi më i lartë drejtues dhe vendimor i shoqërisë dhe ajo ushton të gjitha kompetencat që ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për shoqërite tregtare" i njeh asamblesë së ortakëve.

Asamblea e përgjithshme mund t'ja delegojë kompentencat një ose shumë administratoreve caktuar prej saj dhe një pësoni fizik jashtë ortakerisë së shoqërië vetëm mbi bazën e prokurës.

NENI 11

Me vendim të Asamblesë shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose me shumë ortakë të tjera shtetas shqiptarë apo të huaj ose të bashkohet me një shoqëri tjetër tregtare si brenda dhe jashtë vendit.



Asambleja e Përgjithshme e shoqërisë vendos:

- ❖ Mbi ndryshimet në aktin e themelimit dhe statutin e shoqërisë
- ❖ Mbi formimin e filialeve degëve dhe përfaqësive jashtë vendit
- ❖ Mbi rritjen apo zvogëlimin e kapitalit themeltar
- ❖ Mbi ndryshimet në objekt dhe mbi blerjen e pjesëve të kapitalit në shoqëri të tjera
- ❖ Mbi transferimin dhe revokimin e likuidatorëve
- ❖ Mbi mënyrën e operimit me mjetet financiare monetare
- ❖ Mbi emërimin dhe shkarkimin e Administratorit

NENI 12

Kjo shoqëri administrohet nga administratori Znj. Gisela Ndrekë, e bija e Sokol dhe Vjoleta, e datëlindjes 25/05/2000, lindur ne Shkoder dhe banuese në Naraç, Vau Dejes, Shtetase Shqiptare, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me nr. leternjoftimi 033414754, dhe nr. Personal K05525040E, e cila emërohet për një afat 5 (pesë) vjeçar, duke filluar nga data e emërimit, me të drejtë ndryshimi me konsensusin e ortakëve.


Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas.

Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

NENI 13

- 1) Administratorët kanë të drejtë e detyrohen të:
 - a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
 - b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
 - c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
 - d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
 - e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
 - f) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit;
 - g) raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
 - h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.



The image shows two handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the Board members mentioned in the document. The signature on the left is more fluid and cursive, while the one on the right is more formal and structured.

- 2) Administratoret janë te detyruar te thërrasin Asamblein e Përgjithshme, në rastet kur:
 - a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
 - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
 - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- 3) Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
- 4) Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

NENI 14

Përgjegjësitë e Administratorit

- a) Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
- b) Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuar nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
- c) Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, administratori detyrohet:
- d) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjesid;
- e) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- f) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- g) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;
- h) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- i) Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- j) Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- k) Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:
- l) u kthen ortakëve kontributet;

- m) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- n) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- o) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- p) jep kredi.
- q) Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.
- r) Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpérblimin financier, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

EKSPERTI KONTABËL

NENI 15

Veprimet ekonomike financiare të shoqërisë mbyllen me datë 31 dhjetor të çdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabël mbi bazën e aktivit dhe pasivit ngarkohet nga asambleja e përgjithshme një ekspert kontabël i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare te shoqërisë akt gjithvletor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prejt tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë nga ana e asamblesë..

Në perfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit me shkrim, nxjerrjen rezultatit të bilancit vjetor si dhe atë per kontrollet periodike të ushtruara e cila është e detyruar t'ja paraqesë dhe dorëzojë në kohë ortakëve për t'I shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

NENI 16

Nxjerra e rezultateve të bilancit vjetor duhet bërë me saktësi duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen nga ligji për kontabilitetin dhe atyre të sistemit të taksave që janë të detyrueshme per t'u zbatuar nga çdo subjekt privat që ushtron veprimtari tregtare.

NENI 17

Bilanci kontabël vjetor miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim të Asmablesë së Përgjithshme e cila jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj duke patur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit te vecante etj.

NENI 18

Të ardhurat neto (dividenti) që mbeten pas veçimit të fondeve ligjore të mesipërme dhe të atyre për shlyrjen e çdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbisin dhe i kalojnë në pronësi ortakëve të shoqërisë sado qofshin ato.

PRISHJA E SHOQËRISË

NENI 19

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë dhe për çfarëdo shkaku edhe para plotësimit të afatit për të cilën është krijuar siç mund të jenë, Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejashëm të veprimtarise së saj një nga mënyrat e parashikuara nga ligji “Për falimentimin”

Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

Në këto raste Asambleja e Përgjithshmë merr vendim me shkrim në të cilin parashikohet mënyra e likujdimit të shoqërisë duke caktuar një ose disa likuidatore dhe duke shënuar ne çdo document të nxjerrë prej tij dhe emertesën “Shoqëri në likujdim e sipër”.

NENI 20


Afati i emëritit të likuidatorit publikohet sipas kushteve që parashtron ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentet që duhen depozituar në aneksin e regjistrat në QKR.

NENI 21

Përsa nuk është shprehur në këtë statut i referohet vendimeve plotësuese dhe të ligjshme, dhënë nga Asambleja e Përgjithshme si dhe legjislationi në fuqi.

ORTAKET THEMELUES

ANA SHURDHA



GISELA NDREKA

